

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) është institucion i pavarur, i themeluar për të administruar sistemin e kursimeve të obligueshme pensionale në Kosovë, dhe vepron në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-101 për fondet pensionale në Kosovë dhe me plotësimet e mëtutjeshme të këtij ligji. FKPK-ja, në përputhje me nenin 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 e shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

për angazhimin me kontratë për punë dhe detyra specifike sikur në vijim:

Titulli i pozitës: PROGRAMUES ME PËRVOJË PËR MIRËMBAJTJEN, NDRYSHIMIN DHE AVANCIMIN E UEBFAQES SË FKPK-SË

Orët e punës: Jo më shumë se 120 ditë në vit (kryesisht punë në distancë)

Numri i referencës: KON062024

Kohëzgjatja e emërimit: Kontratë për punë dhe detyra specifike

Adresa: Rr. "Agim Ramadani" Nr. 182-184, 10000 Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë e programuesit:

- Të përditësojë uebfaqen e FKPK-së në platformën Wordpress.
- Të sigurojë që uebfaqja e FKPK-së t'i ketë të zbatuara në përpikëri të gjitha masat për mbrojtje dhe parandalim të cenimit të sigurisë së uebfaqes.
- T'i zbatojë në kohë dhe me saktësi të gjitha kërkesat e FKPK-së për ndryshimin, plotësimin dhe përmirësimin e pjesëve të caktuara ose të gjithë Themes të Wordpress (që përfshin dizajnin, funksionalitetet, plug-ins dhe kodin e uebfaqes).
- Të koordinohet me Menaxherin e Njesisë së Marrëdhënieve me Publik për të gjitha veprimet dhe ndryshimet në uebfaqen e FKPK-së.

Kriteret e konkursit:

Edukimi: • Diplomë e studimeve universitare, në lëmi të teknologjisë së informacionit, ose së paku në vitin e fundit të studimeve.

Certifikimet: • Kandidatët me certifikime relevante (për pozitën e shpallur këtu), do të kenë përparësi.
• Së paku tri vjet përvojë e dëshmuar profesionale në projekte të kodimit, mirëmbajtjes, përditësimit dhe zhvillimit të uebfaqeve në platformën Wordpress.

Përvoja: • Përvojë në zhvillimin e Themes të Wordpress.
• Përvojë në zhvillimin dhe përditësimin e plug-ins të Wordpress.
• Përvojë në HTML, CSS, JAVASCRIPT.
• Njohuri solide për MySQL.

Dëshmi: • Të ketë dëshmi që e mbështesin angazhimin minimal të përvojës së punës së kërkuar.

Afati dhe mënyra e konkurrimit:

- Konkursi është i hapur **prej 22 gushtit 2024 e deri më 5 shtator 2024 në ora 23:59 (CET)**.
- Aplikimi bëhet vetëm përmes email-it në adresën: **recruitment@trusti.org**, me referencë: "Programues i uebfaqes".
- Email-it duhet t'i bashkëlidhen edhe dokumentet në vijim: biografia (CV); letërmotivimi dhe certifikatat profesionale në fushën përkatëse (nëse ka) - të gjitha në formatin pdf.

Vërejtje: Aplikacionet pa dokumentet e lartcekura të bashkangjitura, ose që nuk janë në formatin e kërkuar, NUK do të shqyrtohen. Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet do të kontaktohen.

FKPK-ja është punëdhënës që ofron mundësi të barabarta për të gjithë!